# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-447377**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Koncesionet në shëndetësi/ A janë paracaktuar tenderat 18 mln € për Vilma Nushin?! - REPORT.AL |
| ADRESA | `https://report.al/koncesionet-ne-shendetesi-a-jane-paracaktuar-tenderat-18-mln-e-per-vilma-nushin/` |
| BURIMI | report.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 20:44:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 20:42:52 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 39f3e41bc0051143b72f91100d792c226136ba4c5c1e12974e3a0bf4cfca90dc |
| TEKSTI | 3a4ce92a1a9045144fe381c99e072794ccfdaf129dbb44e93f5a4bc55b104146 |
| PAMJA | e965f3d74f7c897463f1abc850abb900a4a322ac0ac37f5c0800d0f37487c1bc |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 8b00ca1610270deaec9497eba479edbef3edc9611295eb2b2a3185d1951c2552 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | aa0d8cfc8113ea79b7663cf26341788a60de665698217179c4b01fa71930ced4 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8b00ca1610270deaec9497eba479edbef3edc9611295eb2b2a3185d1951c2552`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Koncesionet në shëndetësi/ A janë paracaktuar tenderat 18 mln € për Vilma Nushin?!

by Bota Bota — September 15, 2026 in Aktualitet, Ekonomi, Kryesore, Politike

0 SHARES Share on Facebook Share on Twitter

Tre koncesionet e famshme në shëndetësi, të dhëna 10 vite më parë, afati i të cilave ka përfunduar dhe me letra duhet të menaxhohen nga vetë shteti, po sjellin një tjetër dosje të denjë për Prokurorinë e Posaçme.

Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore ka marrë në dorë hemodializën, sterilizimin dhe kontrollin bazë të popullsisë, ndërkohë që edhe pas shtetëzimit, sërish paratë e prokuruara nga ky ent publik po kanalizohen te të njëjta duar.

Gjithçka nisi me sterilizimin, ku megjithëse një pjesë e mirë e ish-zyrtarëve shtetërore janë vënë nën akuzë, sërish Operatori i ka dhënë tenderat "shokëve" të tyre, të cilët pasi ikën nga firma koncesionare hapën kompani. Ndërkohë, e njëjta situatë ndodhi edhe me hemodializën, ku firma që menaxhoi për 10 vite shërbimin dhe mori nga shteti një shumë rreth 90 milionë euro, fitoi tenderin prej rreth 50 milionë eurosh.

I njëjti Operator shtetëror, i cili pavarësisht lëkundjeve të ndryshimit ministres së shëndetësisë, ka në "dorë" disa tendera për kontrollin bazë të popullsisë, të hapura disa javë më parë. Dokumentet e hulumtuara nga Vox News tregojnë se paratë pritet të kanalizohen sërish te firmat që kanë pasur koncesionin, ndërkohë që shuma totale e tenderuar deri më tani është plot 18 milionë euro.

Kërkesat e veçanta të vetë shtetit duket se i përshtaten më së miri firmës që menaxhoi këtë shërbim, mjaft të debatuar, duke qenë se të gjitha strukturat e shtetit u vunë në shërbim të privatit.



**NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri: "Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit", sha
Adresa: Tiranë, Pasuria Nr. 55/17, Zona Kadastrale Nr. 1751, Gjokaj, Vorë, Tiranë
Tel/Faks: +355692095646
E-mail: prokurime@oshis.al
Ueb-faqe: www.oshis.al

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur, mbi kufirin e lart monetar**

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-99204-09-09-2026

**LOTI 1: REF-99206-09-09-2026**
**LOTI 2: REF-99208-09-09-2026**
**LOTI 3: REF-99210-09-09-2026**



## TË FUNDIT

Koncesionet në shëndetësi/ A janë paracaktuar tenderat 18 mln € për Vilma Nushin?!
SEPTEMBER 15, 2026

"Ish-krerët e UÇK-së meritojnë pafajësinë", një ditë para vendimit, Berisha: Sytë e shqiptarëve drejt Hagës
SEPTEMBER 15, 2026

Video/ Pas Ballukut, edhe Balla përballet me protestuesit: O hajdut, o hajdut
SEPTEMBER 15, 2026

VIDEO/ Shembet vinçi në Miami, operatori shpëton në momentin e fundit, katër të plagosur
SEPTEMBER 15, 2026

Aksidenti në Shkodër/ Autori i dehur i përplasjes dhe viktima ndëshkohen njësoj
SEPTEMBER 15, 2026

"Rama e çoi Veliajn në burg"/ Hoxha: Ai është përgjegjësi kryesor për drejtësinë që kemi sot
SEPTEMBER 15, 2026

Rama përballë drejtësisë që reformoi
SEPTEMBER 15, 2026

Sytë nga Haga/ Pak orë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së, në Prishtinë ndizet "Flakët e Lirisë"
SEPTEMBER 15, 2026

"Nuk kam bërë asgjë të gabuar"/ U arrestua pas akuzave për sulm, udhëheqësi i Reform UK në Uells jep dorëheqjen
SEPTEMBER 15, 2026

Tre të vrarë nga të shtënat me armë në një dyqan në ...
SEPTEMBER 15, 2026

LOTI 3: REF-99210-09-09-2026
**LOTI 4: REF-99212-09-09-2026**
**LOTI 5: REF-99214-09-09-2026**

**4. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: Blerje kite, reagente dhe materiale mjekësore ndihmëse në kuadër të programit të kontrollit mjekësor bazë", i ndarë në lote:**

**LOTI 1: "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Abbot/ose ekuivalent".**

**LOTI 2: "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Roche Diagnostic/ose ekuivalent".**

**LOTI 3: "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Sysmex/ose ekuivalent".**

**LOTI 4: "Blerje kite/testesh diagnostike për përcaktimin e gjakut okult (FOB)".**

**LOTI 5: "Blerje materiale mjekësore për programin bazë".**

**Faksimile: Tenderi i Operatorit të Shërbimeve të Integruara Shëndetësore për blerjen e medikamenteve për vijimin e kontrollit bazë**

Disa ditë më parë, Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore, ka hapur një tender prej 18 milionë eurosh me objekt "blerje kite, reagente dhe materiale mjekësore ndihmëse në kuadër të programit të kontrollit mjekësor bazë", i ndarë në lote.

Kërkohen kite ose reagent për pajisjet prodhuese Abbot, Roche Diagnostic, Sysmex apo edhe teste diagnostike për përcaktimin e gjakut okult. Është kërkuar edhe blerje materiale mjekësore për programin bazë. Fondi limit i procedurës është plot 1,635,852,309 lekë, ose nëse do ta konvertojmë në euro, shuma shkon në plt 18 milionë euro. Në dokumente përcaktohet se afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është data 28 shtatr 2026, ora 14:00.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve që konkurohet/shumatores së loteve për të cilat konkurron.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 %** e vlerës së **fondit limit për secilin prej loteve që konkurohet/shumatores së loteve për të cilat konkurron**.

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore**, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas Ligjit Nr. 89/2014 "Për pajisjet mjeksore" i ndryshuar.

**Argumentimi**: *Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se:*

**Faksimile: Kriteret e vendosura nga Operatori i përshtaten më shumë kompanisë që ka pasur me koncesion kontrollin bazë mjekësor**

Prej gati një dekade, kompania "3p Life", me pronare biznesmenen Vilma Nushi, mori nga shteti një shumë

prej rreth 100 milionë eurosh për kontrollin bazë të popullsisë, ose siç njihej ndryshe check up. Kompania duhet të linte trashëgimi laboratorët mjekësore në shumë qytete të Shqipërisë, ndërkohë që pas shtetëzimit, këtë shërbim e ka marrë në "dorë" Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore.

Në tenderin e fundit, ky Operator ka vendosur disa kritere që i përshtaten totalisht firmës koncesionare. Një ndër kriteret është "kapaciteti ekonomik dhe financiar".

*"Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve që konkurrohet/shumatores së loteve për të cilat konkurron", thuhet në dokumente.*

Nëse do t'i shohim lotet, bëhet fjalë për kite dhe reagente për pajisjet që ka pasur në përdorim dhe të drejtën e përdorimit firma koncesionare.

Si mund të kenë xhiro vjetore firmat e tjera me këto pajisje?!

Kriteri tjetër është "kapaciteti teknik".

"Operatori *ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve që konkurohet/shumatores së loteve për të cilat konkurron", thuhet në dokumente.*

Sërish e njëjta situatë që duket se "përjashton" firmat e tjera.

Në fund, institucioni shtetëror shkruan se *"operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale".*

A mos vallë këtë autorizim e ka vetëm firma koncesionare?!/ **Vox News**

---

**NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri: "Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit", sha
Adresa: Tiranë, Pasuria Nr. 55/17, Zona Kadastrale Nr. 1751, Gjokaj, Vorë, Tiranë
Tel/Faks: +355692095646
E-mail: prokurime@oshis.al
Ueb-faqe: www.oshis.al

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur, mbi kufirin e lart monetar**

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-99204-09-09-2026

**LOTI 1: REF-99206-09-09-2026**
**LOTI 2: REF-99208-09-09-2026**
**LOTI 3: REF-99210-09-09-2026**
**LOTI 4: REF-99212-09-09-2026**
**LOTI 5: REF-99214-09-09-2026**

**4. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: Blerje kite, reagente dhe materiale mjekësore ndihmëse në kuadër të programit të kontrollit mjekësor bazë", i ndarë në lote:**

**LOTI 1: "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Abbot/ose ekuivalent".**

**LOTI 2: "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Roche Diagnostic/ose ekuivalent".**

**LOTI 3: "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Sysmex/ose ekuivalent".**

**LOTI 4: "Blerje kite/testesh diagnostike për përcaktimin e gjakut okult (FOB)".**

**LOTI 5: "Blerje materiale mjekësore për programin bazë".**

---

**5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)**: Materiale mjekësore të konsumueshme-33140000-3 , Reagentë për laborator- 33696500-0

**6. Fondi limit**: 1,635,852,309.34 (një miliard e gjashtëqind e tridhjetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntë pikë tridhjetë e katër) Lek pa TVSH ose 17,777,138.77 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH.

**LOTI 1 - "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues ABBOT/ose ekuivalent"** me fond limit: 433,217,126.67 (Katërqind e tridhjetë e tre milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH ose 4,707,858.36 (Katër milion e shtatëqind e shtatë mijë e tetë qind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e gjashtë ) Euro pa TVSH;

**LOTI 2 - "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Roche Diagnostic/ ose ekuivalent"** me fond limit: 807,078,556 (Tetëqind e shtatë milion e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH ose 8,770,686.33 (Tetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë tridhjetë e tre) Euro pa TVSH;

**LOTI 3 - "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Roche Sysmex/ ose ekuivalent"** me fond limit: 87,358,066.67 (Tetëdhjetë e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH ose 949,337.83 lekë (Nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e tre) Euro pa TVSH;

**LOTI 4 - "Blerje kite/testesh diagnostike për përcaktimin e gjakut okult (FOB)** me fond limit: 127,312,500 (Njëqind e njëzet e shtatë milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Lek pa TVSH ose 1,383,530.75 (Një milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë pike shtatëdhjetë e pesë ) Euro pa TVSH;

**LOTI 5 - "Blerje materiale mjekësore për programin bazë"** me fond limit: 180,886,060 (Njëqind e tetëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë) lek pa TVSH ose 1,965,725.49 (Një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë pikë dyzet e nëntë ) Euro pa TVSH.

*Vlerat ne Euro në këto dokumenta tenderi janë konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë 92.02 lekë, datë 9.9.2026.*

**7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 36 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

**NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri: "Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit", sha
Adresa: Tiranë, Pasuria Nr. 55/17, Zona Kadastrale Nr. 1751, Gjokaj, Vorë, Tiranë
Tel/Faks: +355692095646
E-mail: prokurime@oshis.al
Ueb-faqe: www.oshis.al

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur, mbi kufirin e lart monetar**

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-99204-09-09-2026

**LOTI 1: REF-99206-09-09-2026**
**LOTI 2: REF-99208-09-09-2026**
**LOTI 3: REF-99210-09-09-2026**
**LOTI 4: REF-99212-09-09-2026**
**LOTI 5: REF-99214-09-09-2026**

**4. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: Blerje kite, reagente dhe materiale mjekësore ndihmëse në kuadër të programit të kontrollit mjekësor bazë", i ndarë në lote:**

**LOTI 1: "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Abbot/ose ekuivalent".**

**LOTI 2: "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Roche Diagnostic/ose ekuivalent".**

**LOTI 3: "Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Sysmex/ose ekuivalent".**

**LOTI 4: "Blerje kite/testesh diagnostike për përcaktimin e gjakut okult (FOB)".**

**LOTI 5: "Blerje materiale mjekësore për programin bazë".**

**Tags:** 3p check-up gjak koncesionet LifeAbbot ministria e shendetesise Operator shtetëror Roche Diagnostic shendetesi Sysmex aTre Vilma Nushi

Previous Post

**"Ish-krerët e UÇK-së meritojnë pafajësinë", një ditë para vendimit, Berisha: Sytë e shqiptarëve drejt Hagës**

Bota Bota

**REPORT.AL**

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

**RUBRIKAT**

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

**MË TË KLIKUARAT**

E rëndë, elektriçisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës 01
0 SHARES

02 Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.